

VENDIM
Nr.972, datë 30.9.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS KOZARË TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kozarë të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kozarë të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.180, datë 31.3.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kozarë, të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kozarë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kozarë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
14	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
16-24	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
25-34	Varrezat publike	Në pronësi
51-53	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
60-109,114-191,198-362,365-379,383-405,408-472,474-477	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
479,480,482,483-488,490-496,498,500,501,503,506	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të	Në përdorim

	ushqimit (toka produktive).	
481,489,497,499,502,504,505	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
654-658	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi